

FORMULAR PËR NJOFTIMIN E MARRËVESHJEVE

SEKSIONI 1

Informacione të Përgjithshme

1.1 Informacion mbi palën/palët njoftuese

Jepni të dhëna mbi:

- 1.1.1 Emërtimin, formën ligjore dhe adresën e ndërmarrjes;
- 1.1.2 Kodin fiskal (nipt);
- 1.1.3 Natyra e biznesit të ndërmarrjes;
- 1.1.4 Xhiron e përgjithëshme kombëtare dhe më gjërë;
- 1.1.5 Xhiron nga shitjet e produkteve brenda vendit dhe jashtë tij, që prek marrëveshja;
- 1.1.6 Emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe/ose teleks, dhe pozicionin e punës së personit të kontaktit;
- 1.1.7 Roli që luan ndërmarrja në marrëveshje.
- 1.1.8 Llojin e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes (kryesor dhe sekondar, specifikoni pozicionin që zë në zinxhirin e prodhimit);

1.2 Informacion mbi palët e tjera pjesëmarrëse në marrëveshje.

Për secilën palë pjesëmarrëse në marrëveshje (me përjashtim të palës/palëve njoftuese) jepni të dhëna për:

- 1.2.1 Emërtimin, formën ligjore dhe adresën e ndërmarrjes;
- 1.2.2 Kodin fiskal (nipt)
- 1.2.3 Natyra e biznesit të ndërmarrjes;
- 1.2.4 Xhiron e përgjithëshme kombëtare dhe më gjërë;
- 1.2.5 Xhiron nga shitjet e produkteve brenda vendit dhe jashtë tij, që prek marrëveshja
- 1.2.6 Emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe/ose teleks, si dhe pozicionin e punës të personit kontakt.
- 1.2.7 Roli që luan në marrëveshje
- 1.2.8 Llojin e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes (kryesor dhe sekondar, specifikoni nivelin që zë në zinxhirin e prodhimit).

1.3 Adresa për shërbimet

Jepni nje adresë ku mund t'ju dërgohet korrespondenca shkresore (mundësisht në Tiranë)

1.4 Caktimi i përfaqësuesve

Në rastin kur njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të jenë të autorizuar me shkrim.

Nëse është bërë një njoftim i përbashkët, të thuhet a është caktuar një përfaqësues i përbashkët.

Nëse po, ju lutemi jepni të dhënat që kërkohen në seksionin 1.4.1 deri 1.4.4.

Nëse jo, ju lutemi jepni të dhëna për secilin nga përfaqësuesit e autorizuar për të vepruar në emër të ndërmarrjeve palë në marrëveshje, duke treguar se cilën ndërmarrje përfaqësojnë.

- 1.4.1 Emri i përfaqësuesit
- 1.4.2 Adresa e përfaqësuesit
- 1.4.3 Emri i personit të kontaktit (si dhe adresa n.q.s është e ndryshme nga 1.4.2)
- 1.4.4 Numri i telefonit, numri i faksit dhe/ose teleks.

SEKSIONI 2

Përshkrimi i marrëveshjes

Paraqisni një përshkrim të shkurtër të marrëveshjes që ka të bëjë me objektin e njoftimit, duke treguar ndërmarrjet palë në to, produktet dhe/ose shërbimet e përfshira dhe qëllimin ekonomik që palët pjesëmarrëse presin të arrijnë nga kjo marrëveshje. Nëse kjo është theksuar në një dokument të shkruar, përshkruani shkurtimisht përmbajtjen e atij dokumenti dhe bashkëlidhni një kopje të tij. Nëse një dokument i tillë nuk ekziston (ose është i pjesshëm), siguroni një përshkrim të detajuar të përmbajtjes së marrëveshjes.

SEKSIONI 3

Informacion për tregun përkatës në marrëveshje

Palët njoftuese duhet të sigurojnë një përshkrim të shkurtër të tregjeve përkatëse të prekura nga marrëveshja.

Tregjet përkatëse të produktit dhe ai gjeografik, përcaktojnë fushën brenda të cilit duhet të vlerësohet çdo kufizim i konkurrencës që rezulton nga marrëveshja.

Pala apo palët njoftuese duhet të sigurojnë të dhënat e kërkuara duke patur parasysh përcaktimet e mëposhtme:

I. Tregu përkatës i produktit

Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato produkte (mallra dhe/ose shërbime), të cilat shihen si të shkëmbyeshëm ose të zëvendësueshëm nga konsumatori, për shkak të karakteristikave, çmimeve dhe përdorimit të paramenduar të tyre. Një treg përkatës produkti mund, në disa raste, të përbëhet nga një numër produktesh të veçanta, të cilat kanë karakteristika fizike ose teknike mjaft të ngjashme dhe janë të shkëmbyeshme ndërmjet tyre.

Faktorët për vlerësimin e tregut përkatës të produktit përfshijnë analizat pse disa produkte ose shërbime përshihen në këto tregje dhe përse të tjerat përjashtohen, duke përdorur përkufizimin e mësipërm dhe duke patur parasysh, për shembull, zëvendësueshmërinë, kushtet e konkurrencës,

çmimet, elasticitetin e kryqëzuar të çmimit të kërkesës ose faktorë të tjerë, të nevojshëm për përkufizimin e tregjeve të produkteve.

Përcaktimi i tregut përkatës të produktit përqendrohet në përgjithësi në zëvendësueshmërinë nga pikëpamja e kërkesës. Autoriteti i Konkurrencës për të vlerësuar konkurrencën e përgjithshme në kushtet e tregut, duhet të konsiderojë mundësinë e zëvendësueshmërinë nga pikëpamja e ofertës, dmth, mundësinë për prodhues të tjerë që shndrojnë me lehtësi kapacitetet e tyre për produktet ose shërbimet e hedhura në treg nga ata, në zëvendësim të atyre të ofruara nga palët në marrëveshje.

II. Tregu përkatës gjeografik

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën ku ndërmarrjet palë në marrëveshje përfshihen në ofertën dhe kërkesën e produkteve përkatëse, ku kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene dhe mund të dallohen nga zonat gjeografike fqinje, sepse, në mënyrë të veçantë, kushtet e konkurrencës janë mjaft të ndryshme nga ato zona.

Faktorët që merren parasysh për vlerësimin e tregut përkatës gjeografik përfshijnë: natyrën dhe karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve përkatëse, kostot e transportit, praninë e barrierave të hyrjes, preferencat e konsumatorit, ndryshime të mjaftueshme në pjesët e tregut të ndërmarrjeve midis zonave gjeografike fqinje ose ndryshime të ndjeshme të çmimeve.

III. Tregjet e prekur

Për qëllimet e informacionit të kërkuar në këtë Formular, tregjet e prekura konsistojnë në (apo kanë të bëjnë me) tregjet përkatëse të produktit në territorin e Shqipërisë ku:

- a) Dy ose më shumë palë në marrëveshje angazhohen në veprimtari ekonomike në të njëjtin treg të produktit. Këto janë marrëdhënie horizontale;
- b) Një ose më shumë nga palët në marrëveshje angazhohen në veprimtari ekonomike në një treg të produktit, i cili është në nivelin e sipërm apo të poshtëm të tregut të produktit ku angazhohet çdo palë tjetër në marrëveshje. Këto janë marrëdhënie vertikale.

Në bazë të përcaktimeve të mësipërme identifikoni çdo treg të prekur nga marrëveshja.

IV. Tregjet e lidhura me tregjet e prekura sipas kuptimit të paragrafit III

Përshkruani tregjet përkatëse të produktit dhe gjeografik të prekura nga marrëveshja e njoftuar, të cilat lidhen ngushtë me tregjet e prekura (në tregjet e nivelit të sipërm, të poshtëm dhe tregjet fqinje horizontale), ku ndonjë nga palët në marrëveshje ushtron veprimtarinë dhe të cilat nuk janë vetë tregje të prekura në kuptimin e paragrafit III.

V. Tregjet e paprekura

Në rastin kur nuk ka tregje të prekura sipas kuptimit të paragrafit IV, përshkruani në çfarë produktesh dhe në çfarë hapësire gjeografike të tregjeve do të kishte efekt marrëveshja e njoftuar.

SEKSIONI 4

Informacione të tjera për tregjet përkatëse / Përmasat e tregut

Për çdo treg përkatës të produktit të prekur nga marrëveshja siguroni si më poshtë:

Për secilin nga tre vitet e fundit financiar një vlerësim të madhësisë totale të tregut, në terma të vlerës së shitjeve dhe volumit (njësi) territorin e Shqipërisë dhe sipas gjykimit të palëve njoftuese, kur tregu përkatës gjeografik është i ndryshëm. Tregoni metodologjinë e llogaritjeve dhe siguroni dokumentat ku të konfirmohen këto llogaritje; (tregu përkatës i produktit është përcaktuar në Seksionin III- C.3.1)

Një vlerësim të volumit të shitjeve për produktet e prekura nga marrëveshja, për territorin e Shqipërisë dhe sipas gjykimit të palëve njoftuese, kur tregu përkatës gjeografik është i ndryshëm;

Një vlerësim të vlerës (dhe ku mundet volumin) për të gjithë konkurruesit (duke përfshirë importuesit) të prekur nga kjo marrëveshje. Siguroni dokumenta ku mundet të konfirmoni llogaritjen e këtyre pjesëve të tregut. Siguroni emrin, adresën, numrin e telefonit, të faksit dhe personin e duhur të kontaktit të këtyre konkurruesve;

Një vlerësim të vlerës dhe volumit total, si dhe burimet e importeve nga jashtë territorit të Shqipërisë dhe identifikoni :

a)Përpjesën e këtyre importeve që u përkasin palës (ve) në marrëveshje;

SEKSIONI 5

Informacione për objektin dhe/ose efektet e marrëveshjes dhe mbi pozicionin e palëve në treg/Konkurrentët kryesorë

5.1 Pozicioni konkurrues i secilës palë në marrëveshje për çdo treg përkatës.

Lidhur me këtë siguroni:

5.1.1 Një vlerësim të pjesës së tregut të konkurrentëve kryesorë (shqiptarë dhe të huaj sëbashku) që ushtrojnë veprimtarinë në të njëjtat tregje, duke treguar një nga pesë më të mëdhenjtë. Siguroni emrin, adresën, numrin e telefonit, të faksit dhe personin e duhur të kontaktit të këtyre konkurruesve;

5.1.2 Listën e pesë klientëve të mëdhenj të secilës ndërmarje pjesë në marrëveshje, duke siguruar informacionin e nevojshëm për të kontaktuar me ta.

Për secilën nga ndërmarrjet palë në marrëveshje e treguara në seksionin 1, të sigurohet:

5.1.3 Një listë e të gjitha ndërmarrjeve të tjera të cilat ushtrojnë veprimtarinë në tregjet e prekura nga kjo marrëveshje (tregjet e prekura janë përcaktuar në Seksionin 3), ku ndërmarrjet ose personat e grupit kanë individualisht ose bashkërisht 10% ose më shumë

të pjesës së kapitalit, (5% në rastin e ndërmarrjeve të listuara) ose të pjesës me të drejtën e votës, duke specifikuar përqindjen e mbajtur;

Në secilin rast identifikoni zotëruesin dhe përcaktoni përqindjen e zotëruar prej tij.

SEKSIONI 6

Përshkrimi i konkurrencës potenciale

I. Hyrja në treg

- 6.1 Ka pasur ndonjë hyrje të rëndësishme në ndonjë nga tregjet e prekura gjatë pesë viteve të fundit? Nëse përgjigja është “Po”, aty ku është e mundshme, siguroni emrin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe personin e caktuar të kontaktit, si dhe një vlerësim të pjesës ekzistuese të tyre të tregut.
- 6.2 Në gjykimin e palëve njoftuese, a ka ndonjë ndërmarrje (duke përfshirë ato që aktualisht veprojnë vetëm në tregjet jashtë territorit të Shqipërisë) që mund të hyjë në treg? Nëse përgjigja është “Po”, ju lutem shpjegoni përse dhe identifikoni këtë/këta hyrës me emër, adresë, numër telefoni, numër faksi dhe personin e caktuar të kontaktit, si dhe një vlerësim të kohës brenda së cilës mund të ndodhë kjo hyrje.
- 6.3 Përshkruani faktorët e ndryshëm që ndikojnë në hyrjen në tregjet e prekura që lidhen me çështjen në fjalë, duke bërë një vlerësim të hyrjes si nga pikëpamja gjeografike, ashtu edhe nga ajo e produktit. Duke bërë këtë, merrni parasysh, aty ku është e mundur, faktorët e mëposhëm:
- kostot totale të hyrjes (kërkimi dhe zhvillimi, krijimi i sistemeve shpërndarëse, promovimi, reklama, shërbimi, etj.) mbi një shkallë të barasvlefshme me një konkurrues të rëndësishëm që është i suksesshëm, duke treguar pjesën e tregut të një konkurenti të tillë;
 - çdo pengesë ligjore ose rregullatore, në çdo formë që të paraqitet, të tillë si: autorizimet qeveritare, vlefshmërinë e ekskluzivitetit në prodhim ose shpërndarje, ose standartet e ndryshme;
 - çdo kufizim i krijuar nga ekzistenca e patentave, know-how dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale në këto tregje, si dhe çdo kufizim i krijuar nga liçensimi i këtyre të drejtave;
 - rastet në të cilat palët në bashkim janë të liçensuara ose liçensues të patentave, know-how dhe të drejtave të tjera në tregjet në fjalë;
 - rëndësia e ekonomive të shkallës për prodhimin e produkteve në tregjet e prekura;
 - aksesi në burimet e furnizimit, të tilla si disponueshmëria e lëndëve të para.

II. Kërkimi dhe zhvillimi

6.4 Jepni një vlerë të rëndësishme të kërkimit dhe zhvillimit në aftësinë e një firme që vepron në tregun (tregjet) përkatës për të konkurruar për një periudhë afatgjatë. Shpjegoni natyrën e kërkimit dhe zhvillimit në tregjet e prekura, të zbatuara nga palët në marrëveshje.

Duke bërë këtë, merrni parasysh, aty ku është e mundur:

- a) prirjen dhe intensitetin e kërkimit dhe zhvillimit në këta tregje dhe për palët në marrëveshje;
- b) drejtimin e zhvillimit teknologjik për këta tregje, për një periudhë të përshtatshme kohe (duke përfshirë zhvillimet në produktet, proceset e prodhimit, sistemet e shpërndarjes, etj.);
- c) novacionet kryesore që janë bërë në këta tregje dhe ndërmarrjet përgjegjëse për këto novacione;
- ç) ciklin e novacionit në këta tregje dhe ku janë palët në këtë cikël novacioni.

III. Marrëveshjet e bashkëpunimit

6.5 Në ç' masë ekzistojnë marrëveshjet e bashkëpunimit (horizontale dhe vertikale) në tregjet e prekura?

6.6 Jepni hollësi për marrëveshjet më të rëndësishme të bashkëpunimit, ku janë angazhuar palët në marrëveshje në tregjet e prekura, të tilla si: marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit, liçensimit, prodhimit të përbashkët, specializimit, shpërndarjes, furnizimit afatgjatë dhe të shkëmbimit të informacionit.

SEKSIONI 7

Arësyet që marrëveshja nuk kufizon konkurrencën

Tregoni arsyen pse objekti ose efekti i marrëveshjes, sipas palëve që paraqesin njoftimin, nuk pengon, kufizon ose shkatërron konkurrencën në treg apo në një pjesë të rëndësishme të tij.

SEKSIONI 8

Treguesit ekonomikë për përjashtim nga ndalimi i marrëveshjes kufizuese për konkurrencën

Tregoni pse dhe në çfarë mase marrëveshja edhe pse kufizon konkurrencën mund të cilësohet për përjashtim nga ndalimi në veçanti nëse:

- a) Kontribuon për përmirësimin e kushteve të furnizimit të tregut;
- b) Sjell përfitime esenciale për konsumatorët.

Tregoni nëse këto efekte e bëjnë ndërmarrjen shumë konkurruese në tregun ndërkombëtar dhe nëse këto efekte janë fituar në bazë të:

- a) Rritjes së prodhimit;
- b) Përmirësimit të cilësisë së prodhimit;
- c) Përmirësimit të cilësisë së shpërndarjes; dhe
- d) Progresit teknik dhe teknologjik.

Theksoni arsyen pse kufizimet në konkurrencë janë të nevojshme për të arritur qëllimin e theksuar në paragrafin e mësipërm dhe pse këto efekte nuk mund të arrihen pa këtë marrëveshje.

SEKSIONI 9

Dokumentacioni që i bashkëlidhet njoftimit

Njoftimi duhet të jetë i shoqëruar me dokumentat e mëposhtëme:

- a) Një kopje e versionit përfundimtar ose ai më të vonshmi i të gjitha dokumentave përkatëse rreth marrëveshjes;
- b) Një kopje të bilancit të tre viteve të fundit financiarë dhe nëse është e nevojshme kopje të raporteve dhe llogarive vjetore më të vonshme të të gjithë palëve në marrëveshje, sëbashku me bilancin përfundimtar përkatës për palët pjesëmarrëse në marrëveshje;
- c) Kopje të analizave, raporteve, studimeve dhe kërkimeve të përgatitura për qëllimin e vlerësimit të kësaj marrëveshje, lidhur me kushtet konkurrionale të tregut, konkurrentëve (ekzistues dhe potencialë) dhe kushteve në tregjet përkatëse të prekura;

Të gjitha dokumentat bashkëlidhur formularit të njoftimit duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

SEKSIONI 10

Deklarimi

Kur njoftimet janë firmosur nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, këta përfaqësues duhet të paraqesin provë shkresore që ata janë të autorizuar të veprojnë. Autorizimet me shkrim duhet të shoqërojnë njoftimin.

Njoftimi duhet të mbyllet me deklarin e mëposhtëm, i cili duhet të firmoset nga, ose në emër të të gjitha palëve të njoftimit:

I nënshkruari deklaron se, me njohuritë dhe besimin e tij të plotë, informacioni i dhënë në këtë njoftim është i vërtetë, i saktë, i plotë dhe jo mashtrues; që janë siguruar kopje të plota të dokumentave të kërkuara nga Formulari; që të gjitha vlerësimet janë identifikuar si të tilla dhe janë vlerësimet e tyre më të mira të fakteve themelore dhe; se të gjitha opinionet e shprehura janë të sinqerta.

Ata janë të vetëdijshëm për dispozitat e Nenit 73, pika 1, të Ligjit.

Vendi dhe data:

Nënshkrimi:
Emri/at

Në emër të: